INXHINIER SERVISI PËR PAJISJET LABORATORIKE

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Instalon, mirëmban, riparon dhe jep mbështetje teknike për pajisjet biomjekësore;
- Kryen testimet e nevojshme, siguron përputhshmërinë me parametrat, duke ndjekur udhëzimet e prodhuesit. Realizon kalibrimet periodike të pajisjeve sipas planit të paracaktuar;
- Përshtat hardware ose software për përdorimin e tyre në pajisje të ndryshme biomjekësore;
- Ka përgjegjësi për diagnostikimin dhe interpretimin e të dhënave bioelektrike duke përdorur teknika të përpunimit të sinjalit;
- Marrja e informacioneve nga servis-manualet përkatëse sipas aparateve dhe realizimi i zgjidhjes së problemeve;
- Ndjek riparimin në kohë për pajisjet të cilat janë në mirëmbajtje me palë të treta;
- Kryen kontrollin/instalimin e pajisjeve të reja nësë janë brenda standardeve apo parametrave. Realizon përditësime software-ike të pajisjeve mjekësore.

Kriteret e nevojshme:

- Diplomë në Inxhinieri, e preferueshme dega Mekatronikë;
- E preferueshme: 2 vjet eksperiencë në këtë profil ose punë të ngjashme;
- Njohje shumë të mirë të pajisjeve kompjuterike;
- Njohje shumë e mirë e gjuhës Angleze;
- Aftësi për të punuar në grup;

Të gjithë kandidatët e interesuar mund të aplikojnë duke dërguar CV në adresën e emailit: hr@evitaalbania.com

Afati i aplikimit: 30.09.2022

Kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen nga Burimet Njerëzore të Evita sh.p.k për të zhvilluar intervistë dhe testimet e nevojshme.

Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr. 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".